

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë "MAGS" Sh.p.k.**

Sot, më datë 25/10/2024,

- **Z. Sokol Kuka**, shtetas shqiptar, lindur me 01/06/1972, ne Kurjan, mbajtes i dokumentit te identifikimit me nr. personal H20601032A, madhor e me zotesi te plete juridike e per te vepruar;
- **Z. Skerdi Kuka**, shtetas shqiptar, lindur me 13/03/2003, ne Fier, mbajtes i dokumentit te identifikimit me nr. personal K30313019F, madhor e me zotesi te plete juridike e per te vepruar;
- **Zj. Majlinda Kuka**, shtetase shqiptare, lindur me 08/05/1980, ne Aranitas, mbajtese e dokumentit te identifikimit me nr. personal I05508023T, madhor e me zotesi te plete juridike e per te vepruar

Në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit", ka vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "MAGS" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**  
**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "MAGS" Sh.p.k.

**NENI 2**  
**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Zone Kadastrale 8170, me numer pasurie 1/716+1-3, Hyrja 1, Ap. 3, Tirane.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

**NENI 3**  
**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përvèç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4**  
**OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Bar-Restoran;
- Fast food, piceri;
- Strukture akomodimi, hoteleri;
- Dhenie me qira dhe shit - blerje e makinave, motorrave, mjeteve te tjere motorrik etj.

- Punime në fushën e ndërtimit, ndertime civile, industriale, turistike, ekonomike etj.
- Import-eksporti i produkteve ushqimore ne per gjithesi dhe cdo produkti tjeter tregtar.
- Aktivitet ne fushen e tregtimit me shumice dhe pakice dhe import-eksport te mallrave te ndryshme, ushqimore, industriale, tekstile etj.

Shoqëria mund të kryejë gjithash tu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërise të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## NENI 5

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakeve themelues në vlerën 500,000 Lekë (*peseqind mijë*) Lekë dhe është i përbërë nga 3 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Zj. Majlinda Kuka**, zotëron 1 kuotë, me 34% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 170,000 Leke (*njeqind e shtatedhjete mijë*) Lekë dhe 170,000 Leke (*njeqind e shtatedhjete mijë*) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Z. Skerdi Kuka**, zotëron 1 kuotë, me 33 % të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 165,000 Leke (*njeqind e gjashtedhjete e pese mijë*) Lekë dhe 165,000 Leke (*njeqind e gjashtedhjete e pese mijë*) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Z. Sokol Kuka**, zotëron 1 kuotë, me 33 % të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 165,000 Leke (*njeqind e gjashtedhjete e pese mijë*) Lekë dhe 165,000 Leke (*njeqind e gjashtedhjete e pese mijë*) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## NENI 6

### ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
  - Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
- Z. Skerdi Kuka**, shtetas shqiptar, lindur me 13/03/2003, ne Tirane, mbajtes i dokumentit te identifikimit me nr. personal K30313019F, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## NENI 7

### LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 8

### DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përbajtja e Akitit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku i vetem themelues i shoqërisë, duke autorizuar *Administratorin Z. Skerdi Kuka* për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

### ORTAKET THEMELUES

SOKOL KUKA

Sokol Kuka

Skerdi Kuka  


SKERDI KUKA

MAJLINDA KUKA

Majlinda Kuka  
